



**KOSOVO
CSR
NETWORK**



Member of **CSR
EUROPE**

RRJETI CSR KOSOVA



American School of Kosova
Educating the leaders of tomorrow. For a better future.



legal | tax | development



FLEXOGRAPHIC PRINTING HOUSE



ODA EKONOMIKE
E KOSOVES
OF COMMERCE



Fuqizo vetën.



Rruga "Tringë Smajli", nr. 21
Prishtinë
Republika e Kosovës 10000

E-mail: info@csrkosovo.org
Telefon: +383 38 712 715


Na gjeni në:
Web: csrkosovo.org

Facebook & LinkedIn:
Kosovo CSR Network

Instagram:
[csrkosova](https://www.instagram.com/csrkosova)



Plani i Veprimit, Partneriteti i CSR me UNICEF



Pas fillimit të partneritetit me UNICEF me nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit gjatë muajit gusht, dhe tryezës së rrumbullakët të përbashket ku Rrjeti CSR Kosova dhe UNICEF bashkëbiseduan me udhëheqesit e kompanive që operojnë në Kosovë në mënyrë që fuqia e sektorit privat të përdoret në të mirë të fëmijëve dhe rinisë, të poshtëshënuarat janë pikat kryesore të punës së përbashket të planifikuar për 3 muajt e fundit të 2018:

- 1) Punëtori për zhvillimin e kapaciteteve të anëtarëve të CSR dhe anëtarëve të tjerë të mundshëm
 - Ngritja e vetëdijes për SDG-të dhe lidhja me parimet e CSR
 - Start-ups: Transferimi i njohurive mbi fillimin / lidhjen e të rinjve me mundësitë e punësimit / investimi në bizneset e vogla me bazë komuniteti
 - Vullnetarizmi dhe CSR
- 2) Tryeza e rrumbullakët me universitetet publike dhe private vendore mbi nevojën për ndryshime shoqërore
- 3) Gala Darka, ku UNICEF dhe CSR Kosova ftojnë të gjithë aktorët relevantë për nevojën për të investuar në fëmijë dhe të rinj

Plani i veprimit i vitit 2019 do të ndërtohet në bazë të diskutimeve në tre ngjarjet e lartëshënuara dhe ato të mëhershme, dhe do të fokusohet në punën në terren.

MERIDIAN, PJESE E FORUMIT BOTËROR EKONOMIK

Kompania anëtare e Rrjetit CSR Kosova- Meridian, bëhet kompania e parë kosovare që anëtarësohet në Forumin Botëror Ekonomik (World Economic Forum).

Për Meridian Corporation, anëtarësimi në FEB nënkupton konfirmim të pozitës së saj udhëheqëse në treg si dhe mundësi të reja të jashtëzakonshme për ndërveprim me liderë të tjerë të shumtë të industrisë, akademinë dhe ekspertët e shumtë që janë në dispozicion nga FEB, për ta avancuar edhe më tej kompaninë dhe operimet e saj në treg.

The logo for the World Economic Forum, featuring the words "WORLD ECONOMIC FORUM" in a bold, white, sans-serif font, stacked vertically. A white circular arc is positioned behind the text, partially overlapping the letters.

WORLD
ECONOMIC
FORUM

Mbështetja e CSR për "Let's Dance"

Ngjarja Vjetore "Let's Dance"

Akcioni për Nëna dhe Fëmijë organizon për vitin e 4 rradhazi ngjarjen vjetore "Let's Dance" e cila si synim ka mbledhjen e fondeve të cilat përdoren për të mbështetur shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Kosovë. Anëtarët e Rrjetit CSR Kosova vazhdojnë të jenë mbështetës të ngjarjes si dhe të fondacionit, dhe anëtarët tanë janë donatorë të përvjetshëm të eventit si ashtu edhe të Fondacionit "Akcioni për Nëna dhe Fëmijë". Ftojme të gjitha kompanitë të na kontaktojnë rreth mbështetjes shtesë të mundshme, çoftë në mënyrë financiare apo tjera.

01 Nëntor, 2018 ora 20:00h, në Sheshin 21



POSTIMI I PUNONJËSVE, BILANCI I PUNËS & KUSHTET E PUNËS: LEGJISLACIONI I RI NGA EU



-Me ndërrimin e legjislacionit nga BE priten të bëhen ndryshime të dukshme sa i përket jetës dhe kushteve të punës. Në fillim të vitit 2021, kompanitë do të duhet të bëjnë ndryshimet e poshtëshenuara në kushtet e punës që ofrojnë:

- Zgjatja e lejes së atësisë në minimum 10 ditë pune përreth kohës së lindjes së fëmijut;
- Leje nga puna për kohë deri në 4 muaj për prindërit, e kompensuar në më së paku nivelin e pagës për pushim mjekësor, derisa fëmija të jetë 12 vjeç.

Prindërit gjithashtu do të kenë :

- *Të drejta për të kërkuar leje më fleksibile (me kohë të pjesshme ose të caktuar);
- *Të marrin 5 ditë pushim, që kompensohen të paktën në nivelin e pagës së pushimit mjekësor për t'u kujdesur për të sëmurë rëndë ose të afërm të varur prej tyre;
- * Të kërkojnë orar pune fleksibile nëse ata janë prindër që punojnë (me fëmijët deri në 12 vjeç) ose kujdestarët me të afërm të varur duke kërkuar për ti zvogëluar orët e punës, të kenë orë fleksibile të punës dhe mundësitë për marrëveshje të punës.

Puna e politikave të BE-së së CSR Europe përbëhet nga informimi, bashkëveprimi dhe ndikimi i Komisionit Evropian në mënyrë të plotë të respektimit të prioritetëve të vendosura nga Bordi

Për më shumë info, vizitoni faqen zyrtare të CSR Europe:

csreurope.org

KOMPANIA ANËTARE PROCREDIT BANK NDËR MBËSHTETËSIT KRYESORË TË GREEN FESTIVAL

Kompania anëtare e rrjetit,
ProCredit Bank, mbështetëse e
Green Festival.

Festivali i Gjelbër ofron një platformë rrjetëzimi për bizneset e gjelbra, agjencitë qeveritare, donatorët dhe të gjithë akterët relevantë të energjisë së gjelbër për të ndarë praktikat e qëndrueshme mjedisore që korrespondojnë me qëllimet globale për një ambient më ekologjik. Qëllimi kryesor i festivalit është promovimi i bizneseve të gjelbra të Kosovës dhe ngritja e vetëdijes dhe interesit për riciklim, energji të ripërtëritshme dhe efikasitet të energjisë. Duke marrë parasysh se sektori i “gjelbër” është ende në zhvillim e sipër në Kosovë, ky sektor paraqet mundësi të konsiderueshme për rritje ekonomike dhe krijim të vendeve të reja të punës.



MIRËSEARDHJE KIVO LLC!



Mirësëardhje KIVO LLC! Anëtari më i ri i rrjetit CSR Kosova, KIVO LLC ofron një gamë të gjerë produktesh të paketimit me bazë të PP (Polypropilene) për tregun industrial dhe konsumatorë, e gjithashtu prodhon produkte gjysmë të përfunduara për tregun industrial dhe produkte të përfunduara për konsumatorë, por pa e lënë anash asnjëherë aktivitetet të përgjegjshmë ndaj shoqërisë, sidomos në komunën e Kacanikut ku ata operojnë, dhe kanë kontribuar që shumë familje të sigurojnë ekzistencën e tyre. Tani bashkërisht mund të kontribuojmë në shpërndarjen e parimeve të përgjegjshme shoqërore dhe të ndërmarrim aktivitetet të CSR që të adresojmë sfidat që ka shoqëria jonë të karakterit social.

T'A PASTROJMË KOSOVËN

Kompania Anëtare e Rrjetit CSR Kosova, edhe një herë tregon kujdesin ndaj shoqërisë. Aktivitet nga Meridian Express gjatë ditës botërore të mjedisit. aktivitet ky i ndërmar nga Let's do it Kosova për Ditën Botërore të mjedisit dhe do të zgjatë për 3 muaj T'a pastrojmë Kosovën.





**KOSOVO
CSR
NETWORK**

Ky buletin u punua nga Kosovo CSR Network



MEMBER OF

